



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



KUVENDI KOMUNAL OBILIQ

Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly of Obiliq

Në bazë të nenin 11, 12.1 dhe 12.2 shkronja (d), nenit 14 pika 1, nenit 17 shkronja (c), neni 58 shkronja (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-40 (Gazeta Zyrtare Nr.28 e dt.04.06.2008), Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme (Gazeta Zyrtare Nr.52/2009) me ndryshimet dhe Plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205, nenit 72 pika 1.8 nenit 44 dhe 47.3, të Statutit të Komunës së Obiliqit nr.I-34 i dt.25.04.2016, nenit 39 të Rregullores së punës së Kuvendit, nr.-I-95, të dt.29.06.2018, Kuvendi i Komunës pas shqyrtimit të kërkesës të Kryetarit të Komunës nr. 02-020/01-16835 të dt.12.06.2026 dhe Propozimvendimit të Kryetarit të Komunës me nr.02-020/01-16814/26 të dt.12.06.2026 në mbledhjen e mbajtur me dt.30.06.2026 mori këtë këtë:

V E N D I M

Për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për Njësinë Kadastrale-Parcelë nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (tani e tutje AKP) në zonën kadastrale Obiliq

Neni 1

Miratohet Vendimi për Shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për shpronësimin e Njesisë Kadastrale-Parcelës si në vijim :

- **P-72614055-01346-5**; Lloji i shfrytëzimit të parcelës: Tokë Ndërtimore; Shfrytëzimi aktual i parcelës: Oborr-sipërfaqja: 3939; Lloji i shfrytëzimit të parcelës: Tokë Ndërtimore; Shfrytëzimi aktual i parcelës: Shtëpi-Ndërtesë-sipërfaqja: 1908 m² ; sipërfaqja e përgjithshme: 5847 m² . Vendi i quajtur: Novi Obiliq ; Pjesa e Pronës 1/1; Të drejtat: Posedim Individual e cila evidentohet në emër të **KOOPERATIVA BUJQËSORE OBILIQ** **zk.Obiliq**;

Neni 2

Qëllimi i paraqitjes së këtij vendimi për Shpalljen me Interes të Përgjithshëm Publik i Njesisë kadastrale-Parcelës të cekur si në nenin 1 të këtij Propozim Vendimi është shpronësimi dhe pastaj realizimi i projektit për interes publik përkatësisht bartja në pronësi të Komunës të rrugës “Beteja e Hadës” sipas gjendjes faktike të terrenit , rregullimi i lokacionit për kontejnerët e mbeturinave dhe pjesës e cila shfrytëzohet si rrugë nga ana jugperëndimore e cila shfrytëzohet nga disa banorë të lokalitetit në afërsi .

Neni 3

Pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, Komuna e Obiliqit në pajtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 të datës 28 tetor 2010, do t'i drejtohet Qeverisë së Republikës së Kosovës (Departamentit të Shpronësimit) për fillimin e procedurës së shpronësimit për njësinë kadastrale të cekur si më lartë e cila menaxhohet nga AKP-ja.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit, Drejtoria e Planifikimit Urban, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria e Financave.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Kryetarit të Komunës
- Nënkryetarit të Komunës
- Anëtarëve të KK
- DPUKP
- MAPL
- Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Sami Ahmeti